



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351/02-36116

Dt. 19.03.2024

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesë së **Tasim Taç** me banim në Prizren rrugën **“Mazllum Kastrati-Tranziti”nr.//.**ne baze LRP.nr.646/2024,LRP.nr.581/2024 noteri Suna Salla, LRP.nr.2046/2024 noteri Bilgaip Maznikar në bazë të nenit 3 alineja 1pika 7 e lidhur me nenin 17 dhe 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 04/L-212 dt. 31.07.2013, si dhe nenit 3 alineja 1pika1.1,1.4,1.7,1.10,1.17,1.20,1.21 dhe te nenit 5alineja1pika 1.1si dhe nenit 14 alineja 1pika 1.1 dhe ne lidhje me nenin 15 alineja 1 pika1.2 dhe nenit 19 alineja 2 të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110, dhe dhe sipas vendimit per miratimin e HZK per peridhen 2022-2030 Nr.001-011-48192 te dt 31.03.2022, si dhe nenit 85 te LVL dhe te nenit 27,44,46,47,48 si dhe te nenit 125 te LPPA nr.05/031 dt.25.05.2016 si dhe konform nenit14,15,16,17 dhe 18 te Udhezimit Administrativ nr.06.2017 dt.23.05.2017 si dhe konform nenit 4 pika6.1,paragrafi 2dhe paragrafi 14 si dhe konform nenit 34 e Rregullores për Taksa,Tarifa,Ngarkesa dhe Gjoha nga Shërbimet dhe Veprimtaritë Komunale nr. 01/011-46063 dt.28.03.2019 si dhe Vendimit per percaktimin e Taksës administrative per leshimin e lejes ndertimore dhe tarifa per rregullimin e infrastruktures ne teritorin e qytetit te prizrenit nr.01/011-41141 te dt.10.04.2014 merr kete:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Tasim Taç		
Adresa:	Rruga “Mazllum Kastrati-Tranziti”nr.//.		
Telefoni:	//	Emaili:	//

Emri i projektit	Objekti – afarist depo		
Emri i projektuesit	Biro projektuese"Arkitektura",Karafidin Kuka B.I.		
Adresa:	"Fahredin Hoti",pn.83		
Telefoni:	044//	Emaili:	//

Me këtë Vendim,aplikuesit për leje ndërtimore **Tasim Taç** i lejohe ndërtimi i objektit- **afarist-depo P+1** ne rr"**Mazllum Kastrati"-Tranziti**"nr.//,pn.// me numer ngastres **P-71813063-00426-3** me sip.**4126m, Z.K.Petrove**

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa:	Prizren,"//",pn.//	
Zonat (t) Kadastrale	<p>Lokacioni i ndërtimit gjendet në ë Zonën Kadastrale Prizren dhe është i destinuar ZI zone Industriale- depo afarizem</p> <p>Objekti – afarist-depo do të ndërtohet në parcelën numër P-71813063-00426-3 me sip.4126m, Z.K.Petrove me dimensione sipas kopjes së planit.</p> <p>Etazhiteti i objektit do të jetë P+1.</p> <p>Sipërfaqja bruto e përdhësës është $S=1200.0m^2$.</p> <p>Sipërfaqja neto e perdheses është $S=1156.86m^2$.</p> <p>Sipërfaqja bruto e Katit I është $S=1200.0m^2$.</p> <p>Sipërfaqja neto e katit I është $S=1144.38m^2$.</p> <p>Sipërfaqja bruto e objektit është $S=2400.0m^2$(sipas lejes) per pagese</p> <p>Sipërfaqja neto e objektit është $S=2301.24m^2$(sipas lejes)</p> <p>Është miratuar taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore në shumën prej 10056.0 €.</p> <p>Vlera e objektit sipas dokumentacionit teknik është në shumën prej 63,011.00 €</p>	GPS Koordinatat:

Lloji i ndërtimit të propozuar:		
Ndërtimi i ri <input checked="" type="checkbox"/>	Rindërtim <input type="checkbox"/>	Ripatim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:		
Kategoria I	Kategoria II <input checked="" type="checkbox"/>	
A përfshin kërkesa ndryshimin e destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>		
Përdorimi i propozuar:objektit- afarist-depo		

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Tasim Taç** i lejohet ndërtimi i objektit- **afarist-depo P+1**

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
- Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Në kopje të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vëlosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - Projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;

- Kartelën e miratuara nga Drejtoria e Inspektionit – inspektorati i ndërtimit e cila është e nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
- Të dorëzoj njoftim inektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga kproejektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveq në rast kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtin me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi **Tasim Taç** ka kërkuar nga organi kompetent **DUPH** lëshimin e Lejes Ndërtimore për **objektin – afarist depo**.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit, si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:


- Njoftim për plotësim të dokumentacionit 04-353/01-100235, Dt.29.01.2024
- Pëlqimi nga “KEDS-i”.
- Pëlqimi nga Kom.”Hidroregjioni Jugor”.
- Pëlqimi nga Telekomit i Kosovës – PTK-ja.
- Vertetim nga sektori i menaxhimit të mbeturinave nga DSHP.
- Pëlqim nga DSHP-ja-sektori i komunikacionit
- Pëlqimi nga KRU”Dukagjini-Radoniqi” Sh.A.Gjakove.
- Pëlqimi nga Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë
- Leja Mjedisore Komunale
- Kater kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike – për Kategorinë e II

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë s Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Nr.04-351/02-36116,dt.19.03.2024

Bashkepunetor profesional:



Zana Belloda inxh.dip.ark.

DREJTORI:



Pranverim Berisha,jur.

